

TRYEZË DISKUTIMI

Menaxhimi i pandemisë COVID-19: ndikimi i tij në demokracinë dhe prokurimet publike në Shqipëri

23 MARS 2023, 10:30 – 12:00

Vendi: Hotel Rogner

Programi

Pandemia e COVID-19 pati një ndikim të lartë ndaj shoqërisë tonë, duke marrë jetë njerëzore dhe duke shtuar sfidat globale ekonomike, politike, shëndetësore dhe sociale. Si pjesë e një projekti rajonal “Përmirësimi i qeverisjes ndërkombëtare në kujdesin shëndetësor – Pandemia COVID-19 dhe mësimet e nxjerra nga Ballkani Perëndimor” IDM hulumtoi mbi menaxhimin e pandemisë COVID-19 në Shqipëri. Raporti shqyrtoi ndikimin që patën masat kundër pandemisë në gjendjen e demokracisë në Shqipëri, lirinë e shprehjes, dhe prokurimet publike. Raporti gjithashtu shqyrton edhe ndikimin e pandemisë në sferat e tjera në vend, duke përfshirë jetëgjatësinë, punësimin; sistemin e kujdesit shëndetësor, politikën e jashtme, fushatat e dezinformimit, si dhe mbështetjen e organizatave ndërkombëtare ndaj Shqipërisë. Pandemia e COVID-19 ende nuk ka përfunduar dhe nuk mund të përjashtohet mundësia e valëve të reja, megjithatë, shumica e vendeve kanë hequr kufizimet e pandemisë, pasi perceptimi i rrezikut shëndetësor të virusit ka ndryshuar, veçanërisht për popullatat e vaksinuara.

Rreth folësve:

Znj. Aranita Brahaj, drejtore e përgjithshme e organizatës jofitimprurëse Instituti Shqiptar i Shkencave, dhe e projektit OpenProcurementAlbania. Znj. Brahaj do të flasë rreth ndikimit të pandemisë në prokurimet publike në vend.

Në 26 shkurt 2020 qeveria shqiptare amendoi ligjin për prokurimin publik duke i lejuar institucionet publike të kontraktjnë kompanitë pa tender publik nëse ato kompani mund të ofrojnë shërbimet dhe mallrat e kërkuara në raste nevojash urgjente (gjendje si pandemia). Vendimi për të shpallur të gjitha kontratat si “interesa thelbësore të shtetit”, shkaktoi paralajmërime për keqpërdorim të mundshëm të fondeve shtetërore, favorizim, dyshime korrupsioni dhe shkelje të interesit publik.

Z. Lutfi Dervishi, gazetar dhe pedagog i mirënjohur në Shqipëri. Z. Dervishi do të flasë rreth masave të qeverisë kundër përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe ndikimin e tyre në lirinë e shprehjes në vend. Z. Dervishi do të trajtojë po ashtu edhe problemin e përhapjes së konspiracioneve në media.

Pandemia shkaktoi edhe një përkeqësim të lirisë së shtypit në vend. Gazetarët nuk kishin asnjë kufizim lëvizjeje si shumica e qytetarëve gjatë izolimit kombëtar, megjithatë konferencat për shtyp nuk ishin të aksesueshme për ta. Si kudo tjetër, edhe Shqipëria u prek nga teoritë e konspiracionit gjatë pandemisë. Shqipëria vlerësohet si vendi me numrin më të madh të mbështetësve të teorive konspirative të COVID-19 në Ballkanin Perëndimor. Një çështje shqetësuese për Shqipërinë në këtë drejtim është se konspiracione të tilla u promovuan edhe në kanalet televizive të njohura, përveç mediave sociale dhe portaleve online.

Znj. Ardita Kolmarku, juriste dhe koordinatore projektesh e organizatës jofitimprurëse Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Znj. Kolmarku do të flasë rreth masave të qeverisë kundër përhapjes së pandemisë COVID-19 dhe ndikimin e tyre në demokracinë e vendit.

Shqipëria ndërmoi masa të ashpra për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Masat e vendosura përfshinin, ndër të tjera, kufizim lëvizjeje, gjoha administrative për shkelje të kufizimit të lëvizjes, karantinë dhe kriminalizim të shkeljes së karantinës dhe infektimit të qëllimshëm, si dhe përdorimin e forcave policore dhe ushtarake për të zbatuar këto masa. Avokati i Popullit shprehu shqetësimin rreth pjesëmarrjes demokratike, lirinë e lëvizjes dhe tubimit, kufizimet në të drejtën e jetës familjare dhe privatësisë dhe promovoi në mënyrë proaktive parimet e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në lidhje me legjislacionin gjatë pandemisë.



10:15 -10:30	Regjistrim & Kafë
10:30-11:00	Fjalët hapëse  Z. Gjergji Vurmo , Drejtor Programi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim  Dr. Skënder Brataj , Drejtor i Përgjithshëm, Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore  Znj. Erinda Ballanca , Avokati i Popullit
11:00-11:15	Prezantimi i gjetjeve të raportit Përgjigja e Shqipërisë ndaj pandemisë COVID-19  Z. Romario Shehu , Hulumtues, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
11:15-11:45	Panel diskutimi rreth menaxhimit të COVID-19 në Shqipëri: ndikimi i tij në demokracinë dhe prokurimet publike  Moderues: Z. Gjergji Vurmo , Drejtor Programi, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim








BCSP Belgrade Centre
for Security Policy



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

	 <p>Folës: Znj. Aranita Brahaj, Drejtore e Përgjithshme, Instituti Shqiptar i Shkencave</p>  <p>Folës: Z. Lutfi Dervishi, Gazetar dhe Pedagog</p>  <p>Folës: Znj. Ardita Kolmarku, Juriste dhe Kordinatore Projektsh, Komiteti Shqiptar i Helsinki</p>
<i>11.45-12:00</i>	Diskutim mes pjesëmarrësve
<i>12:00 –</i>	Dreka



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World